

VENDIM
Nr.390, datë 21.6.2006

PËR SISTEMIN E IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE DHE REGJISTRIMIN E
FERMAVE BLEGTORALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pikat 6, 7, 38 e 39, 24, shkronja “b”, e 32, pika 6, të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar” dhe të nenit 4 të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoritet përgjegjës për regjistrin kombëtar të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale është drejtoria, që mbulon fushën e veterinarisë, në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij autoriteti përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

2. Për qëllimet e këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) “Fond kundërparti”, është fondi i krijuar nga pagesat e fermerëve për bazën materiale të sistemit të identifikimit të kafshëve dhe që përdoret për blerjen, në vazhdimësi, të materialeve për funksionimin e këtij sistemi.

b) “Operator privat” është personi i kontraktuar nga sektori veterinar i qarkut, për zbatimin në terren të identifikimit të kafshëve.

3. Drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit (sektori veterinar i qarkut) drejtojnë dhe zbatojnë, për çdo zonë që mbulojnë, sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, nëpërmjet specialistëve privatë, veterinerë dhe zooteknikë, me të cilët lidhin kontratat përkatëse.

4. Fermerët kontribuojnë në përballimin e kostos financiare për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe për regjistrimin e fermave blegtorale, si dhe për pagesën e bazës materiale dhe për shërbimin e kryer nga operatorët privatë.

5. Pagesa e fermerëve për shërbimin e ofruar bëhet drejtpërdrejt tek operatorët privatë, në vlerat, si më poshtë vijon:

a) Për gjedhin — 100 (njëqind) lekë, për çdo kafshë të matrikuluar.

b) Për bagëtinë e imta-20 (njëzet) lekë, për çdo kafshë të matrikuluar me matrikul individual dhe 5 (pesë) lekë për kre, për matrikulimin e kafsheve të reja, për therje.

Në shërbimin e kryer nga operatori privat përfshihen matrikulimi i kafshës dhe plotësimi i formularëve respektivë.

6. Pagesa e fermerëve për bazën materiale të sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale mbledhet nga operatorët privatë në çastin e matrikulimit të kafshëve dhe depozitohet në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, të cilat e derdhin këtë shumë në një numër të veçantë llogarie, për Institutin e Kërkimeve Veterinare për krijimin e fondit kundërparti.

Ky fond të përdoret për blerje, në vazhdimësi, të materialeve për sistemin e identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale, sipas udhëzimit përkatës të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me urdhër, përcakton çmimin e bazës materiale që do të paguajnë fermerët, në bazë të konkurrencës së jo më pak se tri ofertave.

7. Organet e qeverisjes vendore dhe të Policisë së Shtetit bashkëpunojnë dhe mbështesin

drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe ushqimit për zbatimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale.

8. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

9. Vendimi nr.19, datë 28.1.2002 i Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha